

Pas dorëheqjes së Haradinajt, SHBA-ja po e vëzhgon situatën me vëmendje

Faqe 3




VV-ja e quan të papranueshëm mosveprimin e Prokurorisë

Faqe 5



Erdogan kërcënon se do t'ia kthejë shpinën SHBA-së nëse s'ia shet bombarduesit

Faqe 6



KOHA për kulturë: Shqiptarët në Stamboll gjatë shekullit XVII

Faqe 21-27



e shtunë • 27 korrik 2019

Numri 7912 • Çmimi 0,50 €

KOHA

DITORE

www.koha.net



ANALISTËT PERËNDIMORË NUK SHOHIN GJASA KËTË VIT PËR NJË REZULTAT KONKRET TË NEGOCIATAVE KOSOVË-SERBI

Viti 2019 është i humbur për dialogun

Zhvillimet e fundit në Kosovë, por edhe mënyra se si është udhëhequr dialogu në Bruksel, shihen si faktorë që tashmë e bëjnë pothuajse të pamundur synimin e deklaruar për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare Kosovë-Serbi deri në fund të këtij viti

Agron Bajrami

PRISHTINË, 26 KORRIK - E shumëpërfolura "dritare e mundësive", që deri në fund të vitit 2019 të arrihet një marrëveshje finale mes Kosovës dhe Serbisë, duket se është mbyllur përfundimisht. Edhe pse shtytja për arritjen e "kompromisit historik" në muajt e kaluar ka ardhur edhe nga Brukseli, edhe nga Washingtoni, realiteti në terren duket qartë se flet ndryshe.

Kështu vlerësojnë analistë të mirënjohur perëndimorë, të cilët këtë zhvillim e shohin si pasojë të situatës së krijuar në Kosovë, pas dorëheqjes së kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

Gazetari dhe autori britanik, Tim Judah, i cili ka përcjellë zhvillimet në Kosovë dhe rajon që nga vitet '90, thotë se ka shumë pak gjasa që dialogu i Brukselit të rinisë sivejet. Ai thotë se këtë konkludim e nxjerr nga përlogaritja e thjeshtë e bazuar në faktet aktuale.

"Matematika e thjeshtë tregon se ka shumë pak gjasa që dialogu të rinisë deri në vitin e ardhshëm. Nëse zgjedhjet në Kosovë mbahen në vjeshtë atëherë me gjasë do të duhen disa muaj për ta krijuar Qeverinë e re, kohë kjo kur Serbia do të hyjë në periudhë zgjedhore", thotë Judah për "Kohën Ditore". Andaj – shton ai - edhe nëse çështja e tarifave do të hiqej prej tavolinës së bisedimeve, "nuk shoh se diç mund të ndodhë për një kohë shumë të gjatë".

Ai këtë zhvillim e quan lajm të keq, ndërsa dështimin ia faturon mungesës së një lidhshipi me vizion.

"Në aspektin e përgjithshëm – çfarëdo që mund të mendoni rreth ndryshimit të kufijve dhe kështu me radhë – humbja e kohës është lajm i keq. Kanë kaluar 20 vjet prej fundit të luftës dhe Kosova ende është e kurthuar nga trashëgimia e saj. Për dallim, në vitin 1965 marrëdhëniet mes Francës dhe Gjermanisë ishin transformuar në mënyra të paimagjinueshme për gjeneratat paraprake. Në masë të madhe, kjo ishte çështje e lidershit vizionar. E kemi këtë këtu? Nuk mendoj se e kemi", thotë Judah.

Dialogu, "një proces tërësisht i privatizuar" nga Thaçi, Vuçiq e Mogherini

Këndvështrim të njëjtë rreth mundësisë së vazhdimit të dialogut ka edhe njohësi tjetër i zhvillimeve në Ballkan, Bodo Weber, ekspert gjerman pranë Këshillit për Politikë të Demokratizimit (Democratization Policy Council – DPC). Për më tepër, Weber shton se formati i dialogut do të pësojë ndryshime para se të mundë të vazhdojë. Në fakt, ai këtë nuk e quan as "vazhdim", por "riven-dosje" të dialogut.

vijon në faqen e dytë



Foto: Driton Paçarada

Haradinaj e çon veten në Kushtetuese

Prishtinë, 26 korrik - Kryeministri i dorëhequr Ramush Haradinaj, me gjithë kundërshtimet nga PDK-ja, ka vendosur që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me kompetencat për vendimmarrje të Qeverisë së dorëhequr. Kjo ka ngjallur reagime tek shoqëria civile dhe te partitë opozitare, sipas të cilave Qeveria në dorëheqje nuk ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese

PËRKUJTOHET RËNIA E POLICIT TË NJËSISË SPECIALE NË VERI TË MITROVICËS

Tetë vjet nga moszbardhja e vrasjes së heroit Enver Zymberi

Dardane Neziri

PRISHTINË, 26 KORRIK – Tetë vjet janë bërë qëkur institucionet e drejtësisë kanë dështuar të zbardhin vrasjen e policit të Njësisë Speciale, Enver Zymberi, në pjesën veriore të Mitrovicës.

Përvjetori i vrasjes së tij është përkujtuar nga krerët e shtetit në rrjetin social Facebook.

Homazhe para lapidarit dhe varrit të Zymberit kanë bërë pjesëtarë të Policisë së Kosovës, kreu i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, si dhe përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje.

Sistemi i drejtësisë, sipas njohësve të kësaj fushe, ka dështuar karshi

zbardhjes së kësaj vrasjeje. Ata, po ashtu, thonë se që nga koha e vrasjes së Zymberit, Kosova vazhdon të mos e shtrijë autoritetin e plotë në veri të vendit, duke e konsideruar situatën e sigurisë si të brishtë.

Me urdhër të kryeministrit të atëhershëm, Hashim Thaçi, më 26 korrik të vitit 2011, forca të shumta policore ia kanë mësyre Mitrovicës, me urdhrin për shtrirje të sovranitetit të vendit në veri. Afër fshatit Çabër, pas 20 minutave luftime ndërmjet forcave të pjesëtarëve të Njësisë Speciale operative - ROSU dhe një grup personash që u tha se ishin nga komuniteti serb, Zymberi është

qëlluar dhe plagosur rëndë. Pas disa orësh ka vdekur, duke mos arritur t'iu bëjë ballë plagëve.

Pas tragjedisë, sistemi i drejtësisë, duke përfshirë edhe EULEX-in, ka filluar hetimin e këtij rasti dhe në shënjestër si të dyshuar i kanë pasur gjashtë persona, katër prej të cilëve u patën arrestuar. Hetimet kanë përfunduar me ngritje te aktakuzës nga prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Shyqyri Sylja, dhe prokurori i EULEX-it, Pascal Persoons. Mirëpo, në aktakuzë nuk ishte përcaktuar se cili prej të akuzuarve e ka vrarë policin Zymberi.

Aktakuzën prokurori e kishte

bazuar në dëshminë e një pjesëtari të Policisë që ishte në aksion. Ai është i nacionalitetit serb dhe aktualisht ka statusin e dëshmitarit të mbrojtur.

Aktakuza pretendonte se rreth 50 pjesëtarë të Njësisë Speciale Operative – ROSU dhe një grup prej 10 deri 15 personave serbë kishin shkëmbyer zjarr për rreth 20 minuta në afërsi të fshatit Çabër më 26 korrik 2011.

Sipas deklaratave të dhëna prej dëshmitarëve, 8-10 persona kishin dalë prej makinave dhe kishin nisur të përlesheshin me oficerët e Policisë.

vijon në faqen e pestë

BOTIMET
KOHA

**MUAJI I DIASPORËS
PREJ 8 KORRIK DERI MË
9 GUSHT**

**TË GJITHË TITUJT ME
ÇMIME TË PANAIRIT
NË SELINË E GAZETËS
"KOHA DITORE"**

**E HËNË - E PREMTE
(9:00 - 17:00)**

SHKURT

Tre të vdekur nga aksidenti në Bërnjak të Rahovecit

RAHOVEC, 26 KORRIK - Tre persona kanë vdekur dhe tre të tjerë janë lënduar si pasojë e një aksidenti në fshatin Bërnjak të Rahovecit, të premtën pasdite. Lajmin e ka konfirmuar për Koha.net, zëdhënësja e Policisë për rajonin e Gjakovës, Lirije Podrimaj, “Informacioni i fundit nga vendi i ngjarjes është se edhe personi i tretë ka vdekur, viktimat janë dy meshkuj dhe një femër”, ka thënë ajo.

Mospërshtatja e shpejtësisë dhe tejkalimi në mënyrë të pasigurt dyshohet të ketë sjellë tek aksidenti mes dy veturave.

Pas lajmit për aksidentin e rëndë në Rahovec, kanë pasuar reagimet e zyrtarëve të shtetit.

Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, është shprehur i tronditur pas aksidentit, dhe ka dalë në vendin e ngjarjes prej ku u ka bërë apel qytetarëve që të kenë shumë kujdes në komunikacion, sidomos tani që është rritur fluksi i automjeteve në rrugë.

Kryeministri i dorëhequr, Ramush Haradinaj, është shprehur i shqetësuar me rastin dhe ka apeluar te të gjithë qytetarët që ta shtojnë kujdesin në trafik.

Deputeti i LDK-së nga kjo zonë, Avdullah Hoti, ka kërkuar që të shpallet ditë zie në Komunën e Rahovecit. “Raste si ky na tregojnë sa i rëndësishëm është ky kujdes. Policia duhet të jetë shumë strikte në këtë aspekt, sepse kursen jetë njerëzish”, ka thënë Hoti.

Pacolli rehaton këshilltarët e partiakët, dy i dërgon konsuj në Gjermani e një e çon në Çeki

PRISHTINË, 26 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme, në përfundim e sipër të punëve, ka bërë edhe disa emërimë.

Burime të KTV-së kanë bërë të ditur se këshilltarët e ministrit në largim, Pacolli, Liridon Sadriu dhe Dedë Abazi, janë emëruar për konsuj në shtetin e Gjermanisë.

Një tjetër vendim emërimi për konsull, Pacolli e ka bërë për zyrtarin e partisë së tij, Aleanca Kosova e re, Ismet Hajdini, për në shtetin e Çekisë.

KTV-ja ka kontaktuar Sadriun e Hajdinin, të premtën.

I pari ka sugjeruar që pyetjet t'i drejtohen Zyrës për informim, e tjetri, pasi është lajmëruar fillimisht ka mbyllur telefonin më vonë.

Gjithashtu, deri dje, drejtori i Departamentit për Financa dhe Shërbime në MPJ, Blerim Xhemajli, nga informacionet e KTV-së është emëruar për konsull në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri.

Xhemajli, ish-kandidat i PDK-së për kryetar të Suharekës, i kontaktuar nga KTV-ja, ka thënë të jetë emëruar për këshilltar në këtë ambasadë dhe vendimin e ka pranuar në mes të këtij muaji.

Televizioni ka tentuar të marrë përgjigje për këto emërimë nga sekretari i Ministrisë, Fitim Sadiku, drejt të cilit janë dërguar pyetje me shkrim, por i njëjti nuk është përgjigjur as në thirrjet telefonike.

As Zyra për media e kësaj ministrie nuk ka kthyer ndonjë përgjigje për këto emërimë.

ANALISTËT PERËNDIMORË NUK SHOHIN GJASA KËTË VIT PËR NJË REZULTAT KONKRET TË NEGOCIATAVE KOSOVË-SERBI

Viti 2019 është i humbur për dialogun

Zhvillimet e fundit në Kosovë, por edhe mënyra se si është udhëhequr dialogu në Bruksel, shihen si faktorë që tashmë e bëjnë pothuajse të pamundur synimin e deklaruar për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare Kosovë-Serbi deri në fund të këtij viti

vijon nga ballina

“Para së gjithash, problemi, pra edhe zgjidhja nuk është në ‘vazhdimin’ e dialogut, d.m.th. të negociatave për një marrëveshjeje finale, gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, në mënyrën se si janë udhëhequr në dy vjetët e kaluar – si një proces tërësisht i privatizuar nga dy presidentët dhe shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, secili me interesin specifik, privat, por bashkërisht duke e lëvizur dialogun drejt diçkaje që ishte përqeshje me kornizën fillestare dhe qëllimet përfundimtare”, thotë Weber, duke theksuar se një situatë e tillë në procesin e dialogut “nuk ishte ogur i mirë për gjendjen e demokracisë në Kosovë dhe në Serbi, por as për gjendjen e Bashkimit Evropian”.

Tendenca negative ai thotë se u ndërpre me ndërhyrjen e kancelares gjermane, Angela Merkel, dhe me Samitin e Berlinit, që u mbajt në prill të këtij viti.

“Mini-samiti i Berlinit, më 29 prill, ishte nisje e procesit që duhej të çonte drejt një rivendosjeje të të gjithë procesit negociues, duke nisur nga korniza e negociimit”, thotë Weber.

Ai, madje, thotë se ngecja në dialog nuk është ndikuar fort nga dorëheqja e kryeministrit Haradinaj dhe zgjedhjet e pritshme të parakohshme – nuk kanë ndonjë ndikim të madh. Për shkak se një rivendosje në një kuptim serioz mund të nisë vetëm në vjeshtën e vonë, pra kur pasardhësi i zonjës Mogherini, zotëri Borrell, të ketë marrë detyrën”, thotë Weber.

Ai thekson se “nuk është serioze” të flitet për arritjen e një marrëveshjeje finale gjatë vitit 201. “Madje edhe në rrethanat ideale, nënshkrimi i një marrëveshjeje vërtet gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme, sigurisht se nuk është i mundur para vitit 2020”.

Ndikimet e Speciales

Edhe Weber, edhe Judah pajtohen se Gjykata Speciale - thirrja e së cilës u mor si shkak nga



Foto: Driton Paçarada

Haradinaj për dorëheqjen nga pozita e kryeministrit – ka pasur dhe do të ketë ndikim në zhvillimet në Kosovë, si dhe në proceset e tjera nëpër të cilat kalon Kosova, prej dialogut deri në procesin e integrimi evropiane.

Madje, Judah thotë se “një nga tragjeditë më të mëdha” në këtë proces është fakti që gjithçka shkoi tepër ngadalë.

“Ajo që kemi parë me rastin Haradinaj, dhe që do ta shohim me aktakuzat, është se politikanët do të kenë mundësinë që ta kthejnë fokusin nga koha e luftës, çështjet nacionale dhe kështu me radhë, në kohën kur çështjet sociale dhe ekonomike do të duhej të ishin primare”, thotë Judah. “Këto e frenojnë Kosovën dhe rajonin”, shton ai, duke theksuar se në një kohë kur ka rezistencë të shtuar për zgjerimin e BE-së dhe ndryshimet e mëdha gjeopolitike në botë ndikojnë edhe Evropën, “çdo gjë që e frenon rajonin është lajm i keq”.

Ndërsa Weber, duke u bazuar në informata dytësore, thotë se në dy vjetët e fundit, Gjykata Speciale tashmë ka luajtur një rol kyç në zhvillimet në Kosovë, meqë ekzistimi i saj ka ndikuar në veprimet e disa prej aktorëve kryesorë në vend.

Sipas tij, praktika e Gjykatës për intervista sekrete lë hapësirë të pakufizuar për spekulime.



“Për shembull, nëse dikush u beson apo jo fjalëve se presidenti Thaçi është intervistuar disa herë gjatë vitit të kaluar, duke e mbajtur sekret këtë fakt të pretenduar dhe duke vazhduar me punë si normalisht, derisa kryeministri Haradinaj caktimin e një interviste të tillë e bëri publike dhe e shfrytëzoi si arsye për të dhënë dorëheqje – e cila në të njëjtën kohë krijon hapësirë për manovra të ndryshme politike”, thotë Weber, duke theksuar se në këtë kuptim, “puna e Gjykatës në këtë fazë ka ndikim të paparashikueshëm në aktorët politikë në Kosovë, ndërsa rasti i fundit i caktimit të intervistave ngriti pyetje edhe në qarqet perëndimore rreth asaj nëse Gjykata është e prirë ndaj ndërhyrjeve politike nga aktorë individualë perëndimorë”.

Duke e ndërlidhur çështjen e Gjykatës me dialogun e Brukselit, Weber thekson se “gjëja më e rëndësishme ishte që shtytja dyvjeçare nga presidenti Thaçi për një zgjidhje me këmbim terri-torësh ka rezultuar me një rezistencë të qartë ndaj ideve të tilla të rrezikshme që u zhvillua tek elitat politike, shoqëria civile, shumica dërrmuese e qytetarëve, përfshirë qytetarët serbë të Kosovës”.

“Kjo do të mbetet, pa marrë parasysh çfarë turbulencash të

Bodo Weber: “Para së gjithash, problemi, pra edhe zgjidhja nuk është në ‘vazhdimin’ e dialogut, d.m.th. të negociatave për një marrëveshje finale, gjithëpërfshirëse, ligjërisht të obligueshme, në mënyrën se si janë udhëhequr në dy vjetët e kaluar – si një proces tërësisht i privatizuar nga dy presidentët dhe shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, secili me interesin specifik, privat, por bashkërisht duke e lëvizur dialogun drejt diçkaje që ishte përqeshje me kornizën fillestare dhe qëllimet përfundimtare”

paparashikueshme që mund të krijojnë në skenën e brendshme politike veprimet e Gjykatës Speciale në të ardhmen”, thotë Weber. “Veç kësaj, kur të kemi një rivendosje të negociatave e edhe në rastin ideal kur Perëndimi të marrë veten dhe t’u kthehet vlerave të veta liberale demokratike, aktorët politikë të Kosovës ende do të jenë të përballur me sfidën që e kishin edhe kur negociatat nisën në korrik të vitit 2017 – të krijojnë një platformë të përbashkët negociuese dhe të veprojnë si një aktor”, konkludon ai.

Ballkanizimi i Evropës...

Por gazetari Judah shprehet i brengosur për të ardhmen, për shkak se, siç thotë, ka lëvizje negative në të gjithë Evropën.

“Kosova dhe rajoni nuk ka kurrfarë mundësie t’i ndikojnë këto, por liderët e tyre mund të bëjnë dallimin e madh nëse do të veprojnë në bashku dhe për të mirën e përbashkët. Kjo tingëllon sikur një banalitet, por është e vërtetë”, thotë ai. “Por... është po ashtu e mundur që nëse ata bashkëveprojnë do të mundë të punojnë për të mirën e tyre të përbashkët, dhe jo të rajonit”, thekson Judah, duke rikonfirmuar mosbesimin tashmë të shprehur në cilësitë e liderëve të rajonit.

Tutje, Judah flet edhe për perspektivën e integritit në BE, e cila sikur e ka humbur drejtimin.

“Deri tani, integrimi në BE është parë si e ardhmja dhe si një mënyrë për t’u ballafaquar me trashëgimitë historike gjatë rrugës. Shpresoj se kjo ende është kështu, por e vërteta është se pjesa më e madhe e Evropës po bëhet e ballkanizuar më shpejt sesa që Ballkani po bëhet i evropianizuar”, thotë ai. “Nuk e di nëse kjo kuptohet mirë në rajon apo nëse njerëzit e rëndomtë e kuptojnë këtë se ky është një kërcënim. Shumë liderë ballkanikë sigurisht se do të mirëprisnin integrimin në një Evropë, ku gjykatat dhe mediat udhëhiqen dhe kontrollohen njëjtë sikur edhe në vendet e tyre, sikur që është çdoherë e më tepër rasti në Hungari dhe Poloni”, thekson Judah, duke konkluduar me fjalët: “Nuk jam shumë optimist...”

© KOHA Ditore